

11.1 RUAJTJA E REGJISTRIMEVE NË MËNYRË AUTOMATIKE

Regjistrimi i krijuar ose i redaktuar ruhet në mënyrë automatike në skedarin e regjistrimeve të përkohëshme.

Gjatë punës në program mund të ndodhin gabime të paparashikuara (si p.sh ndërprerja e komunikimit). Regjistrimi, të cilin sapo e keni krijuar apo redaktuar dhe nuk keni arritur ta ruani, ruhet në mënyrë automatike në skedarin e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht.

Regjistrimet e ruajtura në mënyrë automatike janë të shënuara si "recovery".

Pas rregullimit të problemit, i cili ka shkaktuar ndërprerjen e punës në program, kataloguesi rihap ndërfaqen për katalogim dhe midis regjistrimeve të ruajtura përkohësisht gjenë regjistrimin, që e ka krijuar ose redaktuar para ndërprerjes (shih kap. 11.3).